

Projekti Solar4Kosovo II

Udhëzues për Shpronësim dhe Kompensim për Personat e Prekur nga Projekti - Vendndodhja e Kolektorëve Termik Diellor

Çka është projekti Solar4Kosovo II?

Ndërmarrja e ngrohjes qendrore **Termokos** po zbaton **Projektin e Ngrohjes Qendrore Diellore të Prishtinës – Solar4Kosovo II**, me mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare¹. Qëllimi i projektit është të sigurojë një ngrohje më të pastër dhe më të qëndrueshme për qytetin përmes energjisë termike diellore, duke adresuar njëkohësisht kërkesat në rritje për energji në qytet.

Projekti përfshin tre komponentë kryesor:

- Ndërtimin e një impianti të ngrohjes qendrore, i cili përfshin **kolektorë termik diellor** (me rezervuar nëntokësor për ruajtjen e energjisë termike (PTES), pompë nxehtësie me absorbim dhe ndërtesë ndihmëse me pajisje) (Komponenti 1) në Komunën e Obiliqit.
- Instalimin e **dy tubacioneve të reja të transmetimit** në Komunën e Obiliqit dhe Prishtinës (Komponenti 2), dhe
- Zgjerimin e **rrjetit të ngrohjes qendrore** për të furnizuar më shumë familje (Komponenti 3) në qytetin e Prishtinës (harta është e dhënë në faqen 5).

Shënim i rëndësishëm: *Ky Udhëzues i referohet vetëm Komponentës 1, ndërsa udhëzuesit për dy komponentët e tjerë do të përgatiten kur projekti të jetë në një fazë më të avancuar.*

Komponenti 1 (vendndodhja e kolektorëve termikë diellorë) është i vendosur në anën verilindore të Komunës së Obiliqit, në një pjesë toke publike ku Termokos ka të drejta shfrytëzimi. Megjithatë, kjo tokë aktualisht po përdoret për aktivitete bujqësore nga shfrytëzuesit joformal².

Pse ka rëndësi kjo?

Ndërtimi i kolektorëve termikë diellor dhe PTES do të ndikojë pa dyshim të shfrytëzuesit joformal që aktualisht përdorin këtë tokë për aktivitetet e tyre bujqësore, pasi ata do të duhet të ndalojnë aktivitetet e tyre në këtë tokë në mënyrë të përhershme.

Projekti angazhohet për të siguruar trajtim të drejtë dhe kompensim për këta individë të prekur për t'i ndihmuar ata të ruajnë mjetet e jetesës. Për të arritur këtë, Termokos ka përgatitur një **Plan për Shpronësimin e Tokës dhe Rivendosjen e Mjeteve të Jetesës (PSHTRMJ)** i cili përshkruan procesin e prituri dhe masat e ndihmës që do t'u ofrohen këtyre shfrytëzuesve.

Objektivat kryesorë janë të minimizohen ndërprerjet në mjetet e jetesës, të mbështetet vazhdimësia e aktiviteteve bujqësore sa më shumë që të jetë e mundur (ose përmes ofrimit të qasjes në tokë tjetër ose kompensim financiar), të ofrohet mbështetje shtesë dhe të ruhet transparenca gjatë gjithë procesit.



Ku mund ta gjej dokumentin PSHTRMJ?

PSHTRMJ (duke mbuluar **Komponentën 1** në detaje) është publikuar në faqen tonë të internetit: www.termokos.org. Po ashtu, është i disponueshëm në formë të shtypur në zyrën tonë në adresën e dhënë në faqen 3 të kësaj fletushke. *PSHTRMJ do të përditësohet më pas për Komponentat 2 dhe 3.*

A ka një afat kohor për të aplikuar për ndonjë lloj kompensimi?

Po. Termokos do t'i informojë së pari personat e prekur për “datën e ndërprerjes”, e cila është një afat i caktuar, pas të cilit çdo kërkesë e re për kompensim ose ndihmë nuk do të merret parasysh. Kjo do të jetë gjithashtu data përfundimtare, pas së cilës çdo person që fillon të shfrytëzojë zonën e vendndodhjes së kolektorëve termik diellor nuk do të kualifikohet për mbështetje.

Çfarë do t'ju ofrohet si kompensim?

Dy mundësi kryesore kompensimi do t'u ofrohen shfrytëzuesve joformal të tokës:

- ofrimi i qasjes në tokë bujqësore alternative ose
- kompensim financiar.

Informacione të detajuara rreth secilës mundësi jepen në faqen në vijim.

Për të përcaktuar se cila mundësi është më praktike dhe më e dobishme për të gjitha palët, Termokos do të punojë ngushtë me një ekspert bujqësor. Ky ekspert do të vlerësojë situatën, do të japë rekomandime dhe do të sigurojë që procesi i kompensimit të plotësojë nevojat e atyre që janë prekur. Roli dhe përgjegjësitë specifike të ekspertit bujqësor shpjegohen gjithashtu në detaje më poshtë.

¹ Financimi i ofruar nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD).

² Individë që përdorin/shfrytëzojnë tokë (ose pasuri të tjera) pa pronësi zyrtare ose të drejta ligjore, qoftë formale apo tradicionale.

1



Opsioni 1: Ofrimi i qasjes në tokë bujqësore alternative

Ky opsion ka për qëllim t'ju ofrojë shfrytëzuesve joformal qasje në tokë alternative, të ngjashme me tokën që aktualisht e shfrytëzojnë, duke u mundësuar atyre të vazhdojnë aktivitetet bujqësore. Procesi do të përfshijë:

- Vlerësimi i tokës aktuale:** Eksperti bujqësor do të vlerësojë me kujdes tokën aktuale për të siguruar një vlerësim të drejtë, duke përfshirë:
 - llogaritjen e vlerës së të korrave që mund të humbasin, duke përfshirë rendimentin e sezonit aktual dhe të ardhurat e parashikuara nga korret e ardhshme,
 - vlerësimin e vlerës së infrastrukturës ekzistuese në tokë,
 - vlerësimin e llojeve të të korrave aktuale, cilësisë së tokës, rrugëve për qasje, etj.
- Identifikimi i tokës zëvendësuese:** Termokos, me ndihmën e ekspertit bujqësor, do të punojë për të gjetur tokë të re alternative që ka të njëjtën madhësi ose më të madhe dhe ka cilësi të ngjashme të tokës me tokën aktuale; është afër (ideale brenda 2 km) për qasje të lehtë; dhe është e disponueshme nën një marrëveshje të drejtë qiraje afatgjatë.
- Konsultimet me familjet e prekura:** Termokos dhe një ekspert bujqësor do të takohen me çdo familje të prekur për të prezantuar gjetjet. Pasi të bien dakord, opsioni i zgjedhur (nëse është i disponueshëm dhe i pranueshëm për familjen) do të formalizohet përmes një marrëveshjeje të shkruar.
- Ofrimi i kompensimit:** Termokos do të mbështesë familjet përmes:
 - kompensimit në vlerën e zëvendësimit për përmirësimet në tokën aktuale dhe çdo korrje të humbur,
 - qasjes në tokë të re nën një qira afatgjatë, ku Termokos mbulon tre vitet e para të kostove të qirasë, dhe
 - kompensimit për humbjet e të ardhurave gjatë periudhës së kalimit, bazuar në kohëzgjatjen e përcaktuar nga eksperti bujqësor.
- Familjet gjithashtu do të furnizohen me:
 - **Mbështetje bujqësore dhe ligjore:** Këshilla të personalizuar nga eksperti bujqësor për kalimin në tokë të re alternative, duke përfshirë përzgjedhjen e të mbjellave, përgatitjen e tokës dhe përmirësimin e rendimentit. Familjet do të marrin gjithashtu udhëzime për qasjen në subvencione qeveritare, grante bujqësore ose programe ndihme financiare, si dhe mbështetje ligjore për të kuptuar të drejtat për përdorimin dhe qiradhënien e tokës,
 - **Trajnim profesional dhe ndihmë për punësim:** Termokos është gjithashtu e gatshme të ndihmojë anëtarët e papunë të familjeve për të hyrë në programe trajnimi profesional, duke përfshirë udhëzime për aplikimet dhe mbulimin e tarifave të pjesëmarrjes për një program. Familjet do të informohen gjithashtu për mundësitë e punës në impiantin termik diellor (pavarësisht se punësimi nuk mund të garantohej).

2



Opsioni 2: Kompensimi financiar

Nëse ofrimi i tokës bujqësore alternative nuk është i mundur, Termokos do të ofrojë kompensim financiar për familjet për humbjen e tokës bujqësore të përdorur më parë. Procesi përfshin:

- Vlerësimi i tokës aktuale dhe vlerësimi i shumës së kompensimit financiar që nevojitet:** Eksperti bujqësor do të vlerësojë tokën aktuale siç është përshkruar në Opsionin 1.
- Konsultimet me familjen e prekur:** Termokos dhe eksperti bujqësor do të takohen me familjet për të prezantuar gjetjet dhe për të diskutuar kushtet e kompensimit.
- Ofrimi i kompensimit:** Familjet do të marrin:
 - kompensim në vlerën e zëvendësimit për të gjitha të korrat e humbura dhe përmirësimet e bëra në tokën ekzistuese,
 - një shumë monetare për të mbuluar kostot e qirasë për tokë bujqësore të ngjashme për të paktën 3 vjet,
 - kompensim për humbjet e shkaktuara gjatë periudhës tranzitore.
- Ofrimi i mbështetjes shtesë:** Për familjet që do të marrin me qira tokë të re, mbështetja shtesë do të përfshijë këshilla ekspertësh për përzgjedhjen e të mbjellave, teknikat e produktivitetit dhe strategjitë për rritjen e të ardhurave; ndihmë për identifikimin e subvencioneve qeveritare, granteve bujqësore ose programeve të ndihmës financiare; dhe mbështetje ligjore për të kuptuar marrëveshjet e reja të qirasë.

Të gjitha familjeve do tu ofrohet mbështetje nga Termokos për të hyrë në trajnime profesionale për anëtarët e papunë të familjes, veçanërisht të rinjtë dhe gratë, duke përfshirë udhëzime për aplikimet dhe mbulimin e tarifave të pjesëmarrjes për një program. Familjet do të informohen gjithashtu për mundësitë e punës në impiantin termik diellor (pavarësisht se punësimi nuk mund të garantohej).

Çfarë nëse jeni të pakënaqur ose keni një problem me projektin?

Nëse jeni të pakënaqur me ndonjë aspekt të projektit ose me asistencën e Termokos, mund të paraqisni një ankesë. Për këtë qëllim, Termokos ka krijuar një **mekanizëm për të trajtuar çdo ankesë** lidhur me aktivitetet e projektit. Disa shembuj të ankesave mund të përfshijnë rastet:

- nëse jeni të pakënaqur me mënyrën se si opsionet/mundësitë janë paraqitur/shpjeguar,
- mosmarrëveshje me mënyrën se si eksperti bujqësor ka vlerësuar tokën që po përdorni aktualisht,
- nëse jeni të pakënaqur me opsionet/mundësitë e kompensimit,
- nëse jeni të pakënaqur me rregullsinë e komunikimit që po ndodh.



Si mund të paraqisni një ankesë?

Kushdo mund të paraqesë një ankesë tek Termokos (informacionet e kontaktit jepen më poshtë), në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- verbalisht** (personalisht ose përmes telefonit),
- me shkrim** duke plotësuar formularin e ankesës të projektit të bashkangjitur (shihni faqen e fundit) ose ndonjë formë tjetër të preferuar dhe dërgoni atë përmes dorëzimit personal, postës ose e-mailit si më poshtë.

Paraqitja e ankesës është pa pagesë dhe mund të bëhet në mënyrë anonime, nëse e zgjidhni këtë. Të gjitha ankesat mund të dërgohen tek:

Termokos Sh.A. – Njësia e Zbatimit të Projektit

Adresa: Rr. 28 Nëntori nr. 181, 10000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Tel: +383 44 966 150 apo +383 45 966 150 apo

+383 44 555 680

E-mail: info@termokos.org;

solar4kosova@termokos.org



Ku mund të gjej më shumë detaje rreth ankesave?

Për më shumë informacion rreth mekanizmit të ankesave, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit në www.termokos.org.

Si do ta trajtojë Termokos ankesën time?

Termokos ka krijuar **Njësinë e Zbatimit të Projektit** (NJZP) me dy ekspertë të caktuar për angazhimin e palëve të interesuara. Kur NJZP merr një ankesë, ky do të jetë procesi i trajtimit të saj:

1. Të gjitha ankesat do të regjistrohen në një regjistër ankesash.
2. Do të pranoni një konfirmim për pranimin e ankesës suaj brenda 7 ditëve kalendrike (nëse nuk është dorëzuar në mënyrë anonime).
3. NJZP do të bëjë çdo përpjekje për ta zgjidhur ankesën tuaj me shpejtësi dhe do të ofrojë një përgjigje brenda 15 ditëve kalendrike nga data e pranimit të ankesës.
4. Ju do të informoheni për zgjidhjen e ankesës përmes metodës suaj të preferuar të kontaktit. Nëse ankesa është dorëzuar në mënyrë anonime, përgjigja do të publikohet në faqen zyrtare të Termokos.
5. Nëse çështja nuk mund të zgjidhet nga Termokos, ajo do të përcillet në Komitetin e NJZP-së për shqyrtim të mëtejshëm.
6. Komiteti do të veprojë si mekanizëm i nivelit të dytë për zgjidhjen e ankesave dhe do ta zgjidhë çështjen brenda 30 ditëve kalendrike nga pranimi i ankesës.
7. Dy ekspertët për angazhimin e palëve të interesit në kuadër të NJZP-së do të sigurojnë që ju të informoheni për vendimin e Komitetit.
8. NJZP do t'ju ofrojë gjithashtu një formular për mbylljen e ankesës për të konfirmuar nëse jeni të kënaqur me zgjidhjen e propozuar.


Dhe çfarë ndodh nëse jam ende i pakënaqur?

Nëse mbeteni të pakënaqur me zgjidhjen e ankesës tuaj, mund të kërkonti mjete ligjore përmes sistemit gjyqësor të Kosovës ose Mekanizmit të Pavarur të Përgjegjësisë së Projekteve të EBRD-së (IPAM).

Formulari për ankesa

Numri i referencës (për t'u plotësuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit)	
Emri dhe mbiemri (opsionale) <ul style="list-style-type: none">• Dëshiroj të paraqes ankesën time në mënyrë anonime.• Kërkoj që identiteti im të mos zbulohet pa pëlqimin tim.	
Detajet kontaktuese Ju lutemi shënoni mënyrën si dëshironi të kontaktoheni (me postë, telefon, e-mail).	<ul style="list-style-type: none">▪ Me postë: <i>Ju lutemi jepni adresën postare:</i> _____ _____▪ Me telefon _____▪ Me e-mail _____
Gjuha e preferuar e komunikimit	<ul style="list-style-type: none">▪ Shqip▪ Serbisht▪ Tjetër: _____
Përshkrimi i incidentit për ankesën	Çfarë ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Kujt i ka ndodhur? Cilat janë pasojat e problemit?
Data e incidentit, që ka ndodhur	
	<ul style="list-style-type: none">▪ Incident/ankesë që ka ndodhur një herë (data _____)▪ Incident/ankesë që ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____)▪ Incident/ankesë e vazhdueshme (aktualisht jeni duke u ballafaquar me problemin)
Çfarë prsini të ndërmerret për këtë ankesë?	
Informacioni për kontaktim për pyetje dhe ankesa: Subjekti: Solar 4 Kosovo II Vëmendje: TERMOKOS Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës solar4kosova@termokos.org Telefon: +383 44 966 150 apo +383 45 966 150 apo +383 44 555 680	Nënshkrimi: _____ Data: _____





Solar 4 Kosovo

**PËRDORIMI I TOKËS
NË VENDNDODHJEN
E PROJEKTIT**

Harta e vendndodhjes së centralit termik diellor për projektin Solar4Kosovo II, e cila është subjekt i ndryshimeve në dizajn për Pipedinën B, pasi rruga ende nuk është finalizuar.